



UDHËZUES PËR BASHKËPUNIMIN E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT ME FËMIJËT DHE ME SHOQËRINË CIVILE



Save the Children



Suedi
Sverige



Save the Children



**UDHËZUES PËR BASHKËPUNIMIN
E INSTITUCIONIT TË
AVOKATIT TË POPULLIT
ME FËMIJËT
DHE ME SHOQËRINË CIVILE**

Botimi i këtij materiali u mundësua nga Save the Children u hartua nga Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, Institucioni i Avokatit të Popullit:

Neila PEKA- Komisionere

Anila NEPRAVISHTA- Ndhmës Komisionere

Matilda TYLLI- Ndhmës Komisionere

Ira PAPAGJIKU- Ndhmës Komisionere

Për përgatitjen e këtij materiali kontribuan:

Prof. Dr. Migena LESKOVIKU dhe Alma KORDONI

Koordinues dhe lehtësues të procesit:

Edlira Ngjerci-Menaxhere e zbatimit të Programit, Save the Children

Iva Korumi- Oficere projekti, Save the Children

Tiranë, 2018

Botimi i këtij materiali u mundësua nga Save the Children

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne besojmë se çdo fëmijë meriton një të ardhme të mirë. Në botë dhe në Shqipëri, Ne ndihmojmë fëmijët të kenë një fillim të mbarë në jetë, mundësi për të mësuar dhe mbrojtje ndaj çdo rreziku. Ne bëjmë më të mirën për fëmijët - çdo ditë dhe në kohë krize –për të sjellë ndryshime në jetën e tyre dhe të ardhmen e përbashkët.

Ky udhëzues publikohet në kuadër të projektit “Nga Fëmijët për Fëmijët”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar dhe zbatuar nga Save the Children në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të Popullit dhe Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

@Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave, të përmendura më lart, si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

Pasqyra e lëndës

Akronime	4
Falenderime	5
1. Përmbledhja ekzekutive	8
2. Hyrje.....	10
2.1 Informacion mbi situatën praktike dhe funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri	10
2.2 Prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit në fushën e të drejtave të fëmijëve	12
3. Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijë dhe Shoqërinë Civile	14
3.1 Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me fëmijët	14
3.2 Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me Shoqërinë Civile.....	22
4. Anekset	26
Aneksi 1.1 Instrumentat ligjorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë	26
Instrumentet ligjorë ndërkombëtarë	26
Instrumentet ligjorë kombëtarë	29
Aneksi 1.2 Ushtrim që do të përdoret nga AP për të matur Shkallët e Pjesëmarrjes së Fëmijëve	34
5. Metodologjia.....	36
5.1 Analiza e fokus grupeve dhe intervistave	37
5.2 Pyetjet e intervistave me fokus grup	45
Bibliografia	48

Akronime

KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
BE	Bashkimi Evropian
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
OPCAT	Protokolli Opsional i Konventës për Parandalimin e Torturës dhe të Gjitha Formave të Tjera të Trajtimit Çnjerëzor apo Degradues

Falenderime

Mirënjohje e veçantë dhe një falënderim të madh i shkon të gjithë fëmijëve që kanë marrë pjesë në fokus grupet, të cilët kanë qenë pjesë e grupimit “Zëri 16+” në disa qytete të Shqipërisë si: Durrës, Burrel, Elbasan, Dibër dhe Tiranë. Ata kanë ndarë me ne mendimet, eksperiencat, ndjesitë dhe sugjerimet e tyre mbi informacionin për institucionin e Avokatit të Popullit. Fëmijët i kanë dhënë këtij dokumenti këndvështrimin e tyre mbi bashkëpunimin e Avokatit të Popullit me fëmijët. Pa ndihmën dhe pa mendimet e tyre ky dokument nuk do t’ia kishte arritur qëllimit. Angazhimi i fëmijëve ka qenë i domosdoshëm në të gjitha hapat e procesit, veçanërisht sugjerimet për instrumentet sesi institucioni i Avokatit të Popullit të jetë më afër fëmijëve kanë qenë shumë të dobishme.

Gjithashtu, shprehim falenderim, për të gjithë përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), që i kushtuan kohë dhe u bënë pjesë e intervistave të drejtpërdrejta si pjesë e punës në terren për përgatitjen e udhëzuesit. Të gjithë përfaqësuesit e OSHC-ve ndanë me grupin e punës, mendimet, eksperiencat dhe sugjerimet mbi bashkëpunimin e tyre me institucionin e Avokatit të Popullit si dhe mbi çështjet të cilat janë pjesë e këtij udhëzuesi.

Një falënderim i veçantë i shkon Institucionit të Avokatit të Popullit, në veçanti Komisionerit të Seksionit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe ndihmës-komisionerëve të këtij seksioni, të cilët trajtuan çështjet e udhëzuesit me qasje pozitive drejt një perspektive të përmirësimit të bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit me fëmijët dhe me shoqërinë civile bazuar në respektimin tërësor të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, gjithashtu për Znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, për mbështetjen dhe gatishmërinë e treguar në të gjithë hapat e procesit, veçanërisht në përmirësimin e këtij udhëzuesi.

Falenderime të sinqerta dhe mirënjohje e thellë shkon për Agjencinë Suedeze për Zhvillim Kombëtar, që përmes mbështetjes së tyre u bë i mundur dhe u realizua hartimi i këtij udhëzuesi.

Përmbledhje Ekzekutive

Udhëzuesi: “Për bashkëpunimin e Institucionit të Avokatit të Popullit me Fëmijët dhe me Shoqërinë Civile” është konceptuar si një dokument orientues dhe rekomandues, i cili do t'i vijë në ndihmë institucionit të Avokatit të Popullit për të rritur bashkëpunimin e tij me fëmijët dhe me shoqërinë civile në Shqipëri.

Ky udhëzues ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe shoqërinë civile. Ky dokument vjen në kuadër të marrëveshjes ndër-institucionale midis Organizatës Save the Children dhe institucionit të Avokatit të Popullit dhe është pjesë e projektit “Për Fëmijët nga Fëmijët”, financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Kombëtar.

Institucioni i Avokatit të Popullit është parashikuar për herë të parë në Kushtetutën Shqiptare të miratuar në Nëntor 1998, kurse ligji “Për Avokatin e Popullit” është miratuar nga Parlamenti Shqiptar në shkurt të vitit 1999. Ky ligj është hartuar duke patur parasysh dhe legjislacionin e vendeve të tjera të Evropës, të cilat e kanë krijuar më parë një institucion të tillë. Në fillimet e veta institucioni nuk ka patur një Seksion të veçantë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve duke i parë të drejtat e fëmijëve në kontekstin e përgjithshëm të të drejtave të njeriut.

Në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, të ratifikuar nga shteti Shqiptar përcaktohet ngritja e strukturave të pavarura për monitorimin e zbatimit të saj. Ky detyrim si dhe përmbushja e rekomandimit të Komitetit për Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për ngjitjen e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Përmirësimet në kuadrin ligjor përkatës të realizuara me ndryshimet ligjore në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit, i ndryshuar (ligji nr. 155/2014), mundësuan ngritjen e këtij seksioni.

Roli i Avokatit të Popullit është të mbrojë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të çdo personi nga veprimet e paligjshme, ose të parregullta të administratës publike. Gjithashtu, ky institucion ka si kompetencë promovimin, ndërgjegjësimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në një spektër të gjerë. Institucioni zbaton kompetencat e veta lidhur me të drejtat e fëmijëve kur mundësohet bashkëpunim në nivele të larta pjesëmarrjeje me fëmijët si dhe me shoqërinë civile.

Ndër vite Institucioni i Avokatit të Popullit ka bashkëpunuar me shoqërinë civile në veçanti dhe ka patur përpjekje për të mundësuar bashkëpunimin me fëmijët, por këto përpjekje kanë qenë të fragmentuara dhe jo të instrumentalizuara në një dokument të shkruar apo udhëzues pune. Për të prodhuar një dokument të tillë lindi nevoja e përgatitjes së udhëzuesit për bashkëpunimin e institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe me shoqërinë civile.

Përgatitja e këtij udhëzuesi është bazuar në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të OKB-së, si dhe në kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar lidhur me të drejtat e fëmijëve. Ky udhëzues prezanton instrumentet e bashkëpunimit efektiv midis institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe me shoqërinë civile. Ndër të tjera, prezantimi i modeleve pozitive të formave të bashkëpunimit në vendet e tjera janë pjesë e këtij dokumenti, konkluzionet dhe rekomandimet e udhëzuesit do të jenë shtyllat orientuese të një bashkëpunimi efektiv e të qëndrueshëm ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit, shoqërisë civile dhe fëmijëve.

Hyrje

Ky udhëzues, përcakton efektivitetin e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me organizatat e shoqërisë civile, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

2.1 Informacion mbi situatën praktike dhe funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri

Ashtu siç parashikohet në dispozitat kushtetuese, edhe ligji organik¹ për Avokatin e Popullit, përcakton se Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend.

Avokati i Popullit i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozita kushtetuese dhe në ligje². Në organizimin e tij strukturor, Avokati i Popullit ka disa seksione, një prej të cilëve është Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

1. Ligji nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

2. Neni 2 i Ligjit

Qëllimi i këtij udhëzuesi është:

- a. mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve.
- b. parandalimi i çdo lloj shkeljeje ndaj të drejtave të fëmijëve;
- c. nxit promovimin e praktikave më të mira në fuishën e të drejtave të fëmijëve;
- d. përforcon bashkëpunimin me fëmijët dhe shoqërinë civile për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijëve.

Në themel të këtij dokumenti qëndrojnë parime dhe standarde që kanë në qendër vlera që promovojnë të drejtat e fëmijës si:

- ✓ Çdo fëmijë ka të drejtë që t'i jepet konsideratë primare interesave të tij/të saj më të mirë.
- ✓ Çdo fëmijë ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, pa asnjë lloj diskriminimi.
- ✓ Çdo fëmijë ka të drejtë të shprehë pikëpamjet e tij ose të saj lirisht dhe ka të drejtë për t'u dëgjuar.
- ✓ Çdo fëmijë ka të drejtë për mbrojtje nga abuzimi, shfrytëzimi dhe dhuna.
- ✓ Çdo fëmijë ka të drejtën të trajtohet me dinjitet dhe dhembshuri.
- ✓ Respekti për garanci ligjore dhe masat mbrojtëse.
- ✓ Parandalimi i konfliktit me ligjin si një element thelbësor i çdo politike të drejtësisë miqësore për të miturit.



Çdokush mund t'i drejtohet Avokatit të Popullit nëse do të vërejë se të drejtat e një fëmije nuk respektohen, apo interesi i tij më i mirë është në rrezik për tu shkelur. Po ashtu, një fëmijë,

mund të kontaktojë vetë ose të adresojë një ankesë/kërkesë tek Avokati i Popullit ose përmes prindit, kujdestarit/përfaqësuesit të tij ligjor.

Avokati i Popullit, nëpërmjet Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve ushtron kompetencat në fushën e të drejtave të fëmijëve në:

- Trajtimin/shqyrtimin e ankesave individuale, për mosrespektim apo dhunim të të drejtave të fëmijëve.
- Identifikimin dhe nxjerrjen në pah të veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme e të parregullta nga ana e organeve shtetërore, të cilat ndikojnë drejtpërsdrejti tek fëmijët.
- Studim legjislativ me synim përmirësime të metejshme, lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Promovon ndërgjegjësimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve;
- Përgatit raporte mbi këto çështje pranë autoriteteve përkatëse;
- Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrative.



Me miratimin e ligjit nr. 9094, date 03.07.2003 u ratifikua “Protokolli Opsional i Konventës Për parandalimin e Torturës dhe të Gjitha Formave të Tjera të Trajtitit Çnjerëzor apo Degradues” (OPCAT). Prej tij rrjedh detyrimi për krijimin e një Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i cili tashmë funksionon si një seksion i veçantë pranë Avokatit të Popullit. Pjesë e veprimtarisë së këtij mekanizmi është monitorimi i situatës së të drejtave të njeriut në institucionet e privimit të lirisë. Raportet dhe rekomandimet periodike të dhëna nga ky mekanizëm kanë shërbyer në përmirësimin e standardeve, trajtimit të personave të privuar nga liria, përfshirë këtu edhe personat nën moshën 18 vjeç.

Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ***kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.***

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo dhe studimi. Në çdo rast, inspektimi bazohet në një

metodologji dhe standarde sipas protokolleve të miratuara për këtë qëllim. E rëndësishme është që këto të jenë në një gjuhë miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët.

Sipas nenit 19/1 të ligjit, Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise.

Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet.

Për efekte të hetimit administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë:

- a) të kryejë hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve apo dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton.**
- b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin;**
- c) të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim, dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa imunitet;**
- ç) të kryejë ose të kërkojë ekspertiza.**

Në kryerjen e funksioneve të veta, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, duke marrë periodikisht mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, organizon, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë, siç mund të jenë konferencat apo seminarët kombëtare, tryezat e rrumbullakëta, etj.

Bashkëpunimi i ngushtë me shoqërinë civile për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, realizohet përmes projekteve të ndryshme dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit për këtë qëllim. Kjo kontribuon në realizimin më efektiv në praktikë të garantimit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve.

Pavarësisht se Avokati i Popullit ka rol rekomandues, ligji vendos një detyrim të qartë ndaj organeve të administratës për t’ju përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit, kërkesave apo propozimeve për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit. Përgjigjja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ. Për më tej, Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij.

Gjithashtu, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e GJEDNJ – së për Shqipërinë Avokati i Popullit ka mbikëqyrur zbatimin e tyre nga ana e autoriteteve shqiptare në lidhje me përmirësimin e standardeve për të drejtat e njeriut në Shqipëri.

2.2 Prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në Strukturën Organizative të tij, përbëhet nga 5 Seksione në përbërje të të cilit është dhe Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve që drejtohet nga Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Prioritet: Vazhdimësia e bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit nëpërmjet Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, me fëmijët dhe me shoqërinë civile bazuar në instrumentat e këtij udhëzuesi për të konsoliduar dhe afruar me standardet ndërkombëtare.

Prioritet: përmirësimi i sistemit të të dhënave mbi regjistrimin, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të kërkesave dhe ankesave të fëmijëve dhe për fëmijët adresuar institucionit të Avokatit të Popullit. .



Prioritet: Realizimi i një fushate ndërgjegjësimi në nivel kombëtar mbi informimin dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe aktorëve të shoqërisë

civile mbi rolin dhe funksionimin e Avokatit të Popullit dhe posaçërisht të Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Prioritet: Bashkëpunimi me MAS për të përfshirë në kurrikulat mësimore ose orë ekstrakurrikulare informacion mbi Avokatin e Popullit dhe diskutime të mundshme mbi kërkesat dhe ankesat që fëmijët kanë dhe mendojnë t'ia adresojnë Avokatit të Popullit.



Prioritet: Realizimi i takimeve periodike, forumeve të hapura dhe fokus grupe të ndryshme, të përshtatshme dhe të drejtpërdrejta të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve me fëmijët dhe prindërit për rritjen e informimit, kuptueshmërisë si dhe për të adresuar problematikat të tyre. Njohja me mekanizmin e kërkesë/ ankesave, transparenca si dhe promovimi i rasteve të trajtuara suksesshëm nga institucioni i Avokatit të Popullit.



Prioritet: Respektimi dhe përdorimi i instrumentave të propozuara nga fëmijët dhe nga shoqëria civile në këtë udhëzues, për të mundësuar nivelin më të lartë të pjesëmarrjes së fëmijëve.

Prioritet: Organizimi i fushatave sensibilizuese për të rritur transparencën dhe besimin te Institucioni i Avokatit të Popullit duke i njohur fëmijët me praktikatat më të mira dhe të rasteve të suksesshme të trajtuara nga ky institucion.

Prioritet: Rritja e nivelit dhe formave të bashkëpunimit me shoqërinë civile duke organizuar nga Avokati i Popullit aksione lobuese dhe advokuese mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve.

Prioritet: Realizimi i aktiviteteve lobuese dhe advokuese për të rritur mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit dhe jo vetëm për realizimin e prioritetëve të lartëpërmendura.

Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me Fëmijët dhe Shoqërinë Civile

3.1 Bashkëpunimi të Avokatit të Popullit me fëmijët

Koncepti bashkëpunim është përdorur në mënyra të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Disa autorë kanë rënë dakord ta definojnë atë si një shprehje “punojmë dhe angazhohemi së bashku”. Ky term në kontekstin e këtij udhëzuesi nënkupton angazhim dhe bashkëpunim midis Avokatit të Popullit dhe fëmijëve dhe të rinjve.

Bashkëpunimi cilësor, efektiv, i qëndrueshëm buron nga niveli i lartë i njohjes, perceptimit, kuptueshmërisë dhe pjesëmarrjes aktive nga të dyja palët. Kjo do të sjellë rritjen e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve me synim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Përse përfshirja e fëmijëve është e rëndësishme?

1. KDF-ja u siguron fëmijëve dhe të rinjve të drejtën për t'u përfshirë në vendimet që i prekin ato. Ata kanë të drejtë që pikëpamjet e tyre të dëgjohen dhe të merren seriozisht.
2. Fëmijët dhe të rinjtë kanë një perspektivë unike në jetën e tyre dhe në jetën e fëmijëve dhe të rinjve të tjerë. Dëgjimi dhe mësimi prej tyre do të sigurohemi që: Sfidojnë çdo supozim dhe stereotip mbi atë se kush janë dhe çfarë kanë nevojë. Të kuptojnë më mirë jetën e tyre dhe çfarë mund të ndihmojë në përmirësimin e gjërave për ta dhe për të tjerët.
3. Përfshirja e vërtetë e fëmijëve dhe të rinjve në vendimmarrje mund të rrisë besimin, marrëdhëniet, aspiratat dhe rolin e tyre si qytetarë aktivë. Kjo mund të ndihmojë për të ndërtuar besimin me të rriturit.
4. Fëmijët dhe të rinjtë janë çelës për të ardhur me mënyra të reja dhe të dobishme për të përmirësuar jetën e tyre dhe të fëmijëve të tjerë.



Gjithashtu, nënkupton një marrëdhënie të ndërsjelltë midis institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe fëmijët me institucionin e Avokatit të Popullit.

3.1.1 Rëndësia e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me fëmijët

Ky bashkëpunim i Institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët bazohet në rolin dhe parimet e punës së këtij institucioni si dhe në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të OKB-së dhe instrumentet ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Gjithashtu, ky bashkëpunim kontribuon në parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe fëmijëve.

Aspekti i besueshmërisë ndaj punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, zë një vend të rëndësishëm në nivelin e bashkëpunimit midis fëmijëve me Avokatin e Popullit. Vendosja e raportit të besimit faktorizohet nga niveli i njohjes së rolit

dhe funksionit të këtij institucioni, niveli i pjesëmarrjes së fëmijëve, promovimi i rasteve të trajtuara suksesshëm si dhe nga format e bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit dhe fëmijëve.

Kur ka bashkëpunim efektiv të Avokatit të Popullit me Fëmijët?

Kur fëmijët janë pjesë e prioriteve të Avokatit të Popullit;

Kur ka takime periodike dhe të mirëorganizuar me fëmijët;

Kur flitet me gjuhë mëqësore për fëmijët;

Kur ka nivel të lartë pjesëmarrje aktive;

Kur ka gjithëpërfshirje;

Kur punohet sipas interesit më të lartë të fëmijëve;


Kur ka komunikim të ndërsjelltë;

Kur gjenerohen ide dhe mendime;

Kur ankesat dhe kërkesat e fëmijëve konsiderohen si prioritet;

Kur promovohen bashkëpunime të suksesshme;

Kur fëmijët kanë besim dhe ndihen të sigurtë;



3.1.2 Fushat e Bashkëpunimit

Bashkëpunim i drejtpërdrejtë midis Avokatit Popullit dhe fëmijëve

Një nga format më të rëndësishme të bashkëpunimit me fëmijët është bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me ta. Kontakti i drejtpërdrejtë me fëmijët ndihmon në vendosjen e marrëdhënieve si dhe në vijimin e tyre. Ky kontakt është hapi i parë për bashkëveprimin e ndërsjelltë midis fëmijëve dhe institucionit të Avokatit të Popullit. Gjatë formës së bashkëpunimit të drejtpërdrejtë, fëmijët kanë mundësi të marrin informacion mbi rolin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe të kenë mundësi të marrin përgjigje për pyetjet e



ndryshme si dhe të marrin informacion mbi kërkesat dhe ankesat drejtuar Avokatit të Popullit.

Takimet periodike si dhe vizitat në institucione si: në shkolla, në institucionet rezidenciale, në qendrat e shërbimeve për fëmijët etj, janë një mundësi për të dëgjuar zërin e fëmijëve dhe për të mirëperceptuar nga Avokatit të Popullit shqetësimet dhe problemet me të cilat ndeshen fëmijët, që më pas këto probleme të adresohen në vendin dhe mënyrën e duhur. Ky lloj bashkëpunimi inkurajon fëmijët t'i drejtohen Institucionit të Avokatit të Popullit për çdo ankesë dhe kërkesë të tyre.

Gjithashtu, bashkëpunimi i drejtpërdrejtë i jep mundësi Avokatit të Popullit të vlerësojë dhe të monitorojë realisht situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Bashkëpunim me përfaqësi të fëmijëve

Bashkëpunimi me përfaqësi ka të bëjë me një formë bashkëpunimi, ku një grupim gjithëpërfshirës fëmijësh/të rinjsh përfaqësojnë një numër të madh fëmijësh. Ky lloj bashkëpunimi jep mundësi që shqetësimet e fëmijëve të adresohen në çështje dhe kategorizim prioritesh. Gjithashtu, kjo formë bashkëpunimi jep mundësi që fëmijët të kenë mundësi të advokojnë në partneritet me Avokatin e Popullit çështjet e të drejtat të tyre si dhe të institucionalizojë metodologji pjesëmarrëse për krijimin e hapësirave të qëndrueshme që të dëgjohet zëri i fëmijëve.

Në Shqipëri ka disa grupime fëmijësh të konsoliduara përfaqësimi. Disa prej tyre janë:

Qeveria e Nxënësve, është një mekanizëm ligjor që synon të garantojë angazhimin e drejtpërdrejtë të fëmijëve në vendimmarrje në proceset e jetës shkollore, parashikuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar. Udhëzimi nr. 25 datë 02.08.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve” jep orientimin sesi të ngrihet dhe të bëhet funksional ky mekanizëm. Bazuar në këtë udhëzim, Qeveria e nxënësve ka të drejtë: a) të parashtojë shqetësimet e saj për mbrojtjen e të drejtave të nxënësve të shkollës dhe propozimet për mbarrëvajtjen e shkollës të drejtori i shkollës, këshilli i mësuesve, këshilli i prindërve dhe bordi i shkollës; b) të ketë një vend në shkollë ku të afishojë lajmërimet e veta; c) të botojë gazetën e qeverisë së nxënësve; d) të bashkëpunojë me qeveri homologe nxënësish për organizimin e veprimtarive të përbashkëta; e) t'i drejtohet komisionit të etikës dhe sjelljes të shkollës dhe çdo organizmi tjetër për çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund të shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral

tek nxënësit në mjediset e shkollës. Qeveria e nxënësve ngrihet në bazë shkolle. Zgjedhjet për qeverinë e nxënësve bëhen në fillim të çdo viti mësimor. Anëtarët e qeverisë së nxënësve zgjidhen sipas një procedure të përcaktuar në udhëzim dhe bazuar në një nga parimet e KDF-së, atë të pjesëmarrjes së fëmijëve.

“Zëri 16+...” është një grupim jo formal, jo i institucionalizuar ligjërisht. Grupi Zëri 16+ udhëhiqet nga vetë fëmijët. Ky grup e shtrin aktivitetin e vet në katër qytete të Shqipërisë, si: Elbasan, Durrës, Dibër dhe Burrel. “Zëri 16+...” e ka zanafillën në vitin 2000. Emri i grupit lidhet me numrin e fëmijëve të cilët finalizuan me sukses rishkrimin në gjuhën e fëmijëve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve. Grupi “Zëri 16 +...”, është një model i ardhur nga praktika e drejtpërdrejtë në kontekstin shqiptar, me fëmijët dhe nga fëmijët, tashmë i konsoliduar, i provuar dhe i testuar si i suksesshëm në ushtrimin e të drejtës së fëmijëve për pjesëmarrje jo vetëm në vendimet që ndikojnë drejtpërdrejtë jetën e tyre por dhe në sferën pubike. Grupi “Zëri 16 +...” ka arritur të krijojë një masë kritike të fëmijëve të aftë dhe me potencialet për të edukuar bashkëmoshatarët e tyre dhe të rriturit lidhur me të drejtat e fëmijëve. Ky grup u nis si një nismë e Save the Children, por shumë shpejt, drejtimi u mor nga vetë fëmijët dhe ka ndikuar veçanërisht në dy aspekte. Aspekti i zhvillimit të lidërshit të fëmijëve dhe aspekti i pjesëmarrjes dhe përfshirjes së tyre në shumë aktivitete në nivel lokal dhe qendror.

Qendrat rinore dhe organizatat rinore - janë organizime formale dhe jo formale të të rinjve dhe frekuentohen nga vetë të rinjtë. Këto organizime janë në nivel vendor dhe të bazuara në projekte të ndryshme të shoqërisë civile. Këto qendra operojnë në disa qytete si p.sh; Vlorë, Durrës, Tiranë, Shkodër, Korçë, Fier dhe Elbasan.

3.1.3 Instrumentet për të siguruar bashkëpunim efektiv me fëmijët

Instrumentet³ për të siguruar bashkëpunim efektiv me fëmijët lidhen ngushtësisht me respektimin e të drejtave të fëmijëve sipas perspektivës së fëmijëve. Gjithashtu, këto instrumente i referohen dy aspekteve 1) informimit dhe njohjes së rolit dhe funksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe 2) pjesëmarrjes aktive të fëmijëve.

3. Përkufizimi i instrumentit: një mjet metodë që përdoret për një qëllim të caktuar, një mjet i përgatitur për të bërë punë të kujdesshme dhe të saktë me qëllim përmbytjen e qëllimit.


Instrumentet e bashkëpunimit efektiv konsistojnë në:

- Nxitjen e një grupi përfaqësuesish të fëmijëve, të cilët do të ideojnë dhe zbatojnë aktivitete të përbashkëta midis fëmijëve dhe institucionit të Avokatit të Popullit, si p.sh takime periodike, vizita në zyrat e institucionit të Avokatit të Popullit, forume diskutimi mbi procesin e kërkesës dhe ankesës drejtuar këtij institucioni, etj;
- Promovimi i formave pozitive të bashkëpunimit të fëmijëve me Institucionin e Avokatit të Popullit, ku përfshihen vizita studimore të përbashkëta në vende ku ky bashkëpunim është më i konsoliduar dhe i frytshëm me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve. Përgjegjës për këto aktivitete do të jenë Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.
- Vendosija në kurrikulat mësimore dhe organizim i orëve ekstrakurrikulare me fokus informimin e fëmijëve mbi institucionin e Avokatit të Popullit. Institucioni i Avokatit të Popullit i drejtohet me kërkesë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për të përfshirë në orët ekstrakurrikulare informacion mbi rolin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe orë diskutimi të përbashkëta me fëmijët. Kjo teknikë do të sigurojë që fëmijët nga e gjithë Shqipëria do të informohen dhe do të rrisë bashkëpunimin e fëmijëve me këtë institucion.
- Takime periodike dhe të drejtpërdrejta me fëmijët në shkolla, qendrat rezidenciale, qendrat ditore etj, ku fëmijët informohen mbi rolin e institucionit të Avokatit të Popullit. Në këto takime është shumë e rëndësishme përfshirja e prindërve për të përfutur sa më shumë informacion. Takimet periodike ndihmojnë shumë edhe në rritjen e besimit të fëmijëve për angazhimin e këtij institucioni në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Këto takime mund t'i zhvillojnë Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve si edhe vetë Avokati i Popullit.
- Realizimi i një strategjie komunikimi dhe informimi me fëmijët mbi rolin dhe funksionimin e Avokatit të Popullit. Strategjia e komunikimit do të përfshijë mënyrën e komunikimit midis këtij institucioni dhe fëmijëve. Gjuha miqësore duhet të shoqërojë këtë strategji komunikimi. Për të hartuar këtë strategji komunikimi mund të ngrihet një grup pune i



përbërë nga Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, ekspertë të komunikimit, fëmijë dhe prindër.

- Emisione televizive informues dhe ndërgjegjësuës me gjuhë miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët/të rinjtë mbi funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit. Emisionet televizive janë një medium komunikimi ku informacioni ka një shpërndarje të gjerë dhe ku fëmijët informohen mbi rolin Avokatit të Popullit. Prezantimi i rasteve të suksesshme të trajtuara, do të ndikojë në rritjen e besimit dhe në nxitjen e fëmijëve për t'iu drejtuar këtij institucionit në çdo rast të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.
- Organizim aktiviteteve sipas ideve të fëmijëve në mjediset e institucionit të Avokatit të Popullit bazuar në qasjen miqësore për fëmijët. Vizitat periodike apo organizimi i pritjeve të fëmijëve nga gjithë Shqipëria në mjediset e zyrës së Avokatit të Popullit, mund të jenë një formë e rritjes së bashkëpunimit.
- Organizimi i mbledhjeve në një mjedis të përshtatshëm për të siguruar pjesëmarrje aktive të fëmijëve jo vetëm duke i ftuar ata në takimet dhe mbledhjet e institucionit si pjesë e dekorit, por duke i bërë sa më aktivë dhe pjesëmarrës.
- Pyetësorë të ndryshëm apo fokus grupe për të matur nivelin e bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit dhe fëmijëve dhe për të përfutur feed-back-un e fëmijëve mbi këtë bashkëpunim. Këta pyetësorë mund të iniciohen nga vetë stafi i institucionit të Avokatit të Popullit, por dhe nga organizata të shoqërisë civile;
- Përgatitja e dokumenteve që adresojnë çështje që lidhen me të drejtat e fëmijëve, në një gjuhë miqësore dhe të kuptueshme për fëmijët/të rinjtë. Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve do ta përfshijë këtë metodë duke bashkëpunuar me shoqërinë civile dhe duke kërkuar ekspertizën e tyre për këtë.
- Trajnime me fëmijët që janë pjesë e qeverive të nxënësve apo grupeve të tjera si “Zëri 16+” mbi përgatitjen e kërkesave dhe ankesave drejtuar Avokatit të Popullit. Këto trajnim mund të organizohen nga organizata të



shoqërisë civile, por edhe nga vetë stafi i Avokatit të Popullit, konkretisht Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

- Database me të dhënat e ankesave dhe kërkesave lidhur me çështjet e të drejtave të fëmijëve. Zyra e Avokatit të Popullit të hartojë një program elektronik të regjistrimit të ankesave dhe kërkesave dhe ruajtjes së tyre. Kjo do të ndihmojë në mbledhjen dhe analizën e të dhënave statistikore si dhe monitorimin e ecures së ankesave dhe kërkesave të fëmijëve.



- Komunikim online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Avokatit të Popullit me fëmijët (pyetje- përgjigje). Një person nga seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve të institucionit të Avokatit të Popullit nëpërmjet kësaj forme komunikimi u jep përgjigje pyetjeve që do të kenë fëmijët lidhur me rolin e institucionit si dhe aplikimin e kërkesës apo ankesës. (Gjatë aplikimit të kësaj metode duhet patur në konsideratë ofrimi i shërbimit të internetit të sigurt).



- Bërja publike e rasteve të trajtimit në mënyrë të suksesshme të çështjeve që lidhen me shkeljen e të drejtave të fëmijëve. Kjo metodë do të rrisë besimin e fëmijëve në adresimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve dhe do t'i nxisë ata për të paraqitur raste të shkeljes së tyre.

3.1.4 Si mund të ndihmohen fëmijët për të kuptuar rolin e Avokatit të Popullit

Fëmijët i kuptojnë informacionet si ne të rriturit ua japim atë. Të respektojmë dhe të dëgjojmë mendimet e fëmijëve do të thotë që të kryejmë detyrën tonë në mënyrën më të mirë të mundshme. Institucioni i Avokatit të Popullit është i pranuar



nga fëmijët kur atyre ju krijohet mundësia dhe hapërisa e duhur e komunikimit duke përdorur aspekte të rëndësishme si:

▪ **Gjuha e përdorur**

Gjuha është mjeti me të cilin dërgohet mesazhi, nëse gjuha nuk është ajo e duhura, mesazhi nuk merret si duhet nga fëmijët, ai mund të deformohet. Shpesh institucionet

në nivel kombëtar karakterizohen nga një gjuhë formale dhe shumë zyrtare, kjo lloj gjuhe nuk është e përshtatshme për fëmijët. Është shumë e rëndësishme që institucioni i Avokatit të Popullit të përshtatë gjuhën me fëmijët dhe jo të bëjmë të mundur që fëmijët të mësojnë gjuhën zyrtare dhe shumë formale. Në komunikimin me fëmijët gjuha duhet të jetë sa më e thjeshtë, të përmbajë fjalë nga fjalori i fëmijëve, të jetë e perceptueshme dhe e kuptueshme nga fëmijët në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tyre si dhe duhet të sigurohemi që përkufizimet të kenë kuptueshmëri të njëjtë.

▪ **Metodologjia e dhënies së informacionit**

Metodologjia e dhënies së informacionit i cili i adresohet fëmijëve duhet të jetë miqësore për fëmijët, argëtuese dhe jo e lodhshme për ta. Një mesazh i dhënë në mënyrën e duhur perceptohet, kuptohet, përthithet dhe asimilohet qartë, krahasuar me të njëjtin mesazh, por i dhënë në mënyrën jo të përshtatshme për fëmijët. Referuar kësaj, themi që, metodologjia e dhënies së mesazhit duhet të bazohet në moshën e fëmijëve, aftësinë fizike-mendore, përkatësinë si dhe kontekstin social-kulturor të tyre.

▪ **Marrja e Feedback**

Marrja e feedback-ut nga fëmijët është një aspekt shumë i rëndësishëm në bashkëpunimin e fëmijëve me institucionin e Avokatit të Popullit. Nëpërmjet feedback –ut institucioni i Avokatit të Popullit kupton nëse mesazhi apo informacioni që ka adresuar tek fëmijët është kuptuar prej tyre.

Nëpërmjet asaj fëmijët paraqesin mënyrën sesi e kanë marrë informacionin dhe kuptueshmërinë e tyre mbi këtë informacion dhe ky feedback duhet të shërbejë për të adresuar problemet që mund të shfaqen dhe për marrjen e masave në lidhje me zgjidhjen e tyre. Marrja e feedback-ut të fëmijëve duhet të bëhet nëpërmjet metodave të përshtatshme dhe të kuptueshme për fëmijët.

3.2 Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me Shoqërinë Civile

Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me shoqërinë civile udhëhiqet nga parimet dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve. Ky bashkëpunim është një faktor kyç në realizimin e misionit të Avokatit të Popullit

për të kontribuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Këndvështrimi i shoqërisë civile e ndihmon Avokatin e Popullit në përmbushjen me sukses të këtij misioni.

3.2.1 Format e Bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me Shoqërinë Civile

Disa nga format e bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile janë si më poshtë:

Në nivel strukturor:

Bordi Këshillimor i ngritur pranë Avokatit të Popullit, me anëtarësi të përzgjedhur nga vetë organizatat e shoqërisë civile. Nëpërmjet këtij bordi arrihet të merren opinionet dhe ekspertiza e shoqërisë civile për çështje të ndryshme që shqetësojnë qytetarët dhe opinionin publik. Çështjet e të drejtave të fëmijëve janë pjesë e trajtimit të këtij Bordi.

Ngritja e Komisionit Ad-hoc: Institucioni i Avokatit të Popullit ngreh një grup ad-hoc bazuar në nevojat e trajtimit të një rasti urgjent të shkeljes së të drejtave të fëmijëve. Ky grup do të përbëhet nga stafi i Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve pranë këtij institucioni dhe ekspertë të tjerë nëse ka nevojë.

Dokumentimi dhe raportimi:

Përgatitja e raporteve/dokumenteve dhe rekomandimeve në fushën e të drejtave të fëmijëve. Nëpërmjet, përgatitjes së raporteve, dokumenteve të ndryshëm Avokati i Popullit e bën pjesë bashkëpunuese shoqërinë civile duke shprehur këndvështrimin e saj në fushën e të drejtave të fëmijëve. Ndërkaq, Avokati i Popullit bashkëpunon me shoqërinë civile duke u mbështetur në ekspertizën profesionale të saj në përgatitje raportesh, dokumentesh dhe rekomandimesh.

Monitorimi i të drejtave të fëmijëve:

Avokati i Popullit bashkëpunon me organizata të shoqërisë civile në **monitorimin e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar si dhe në nivel lokal**. Ky monitorim konsiston jo vetëm në partneritet gjatë procesit të monitorimit, por edhe ekspertizën në instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit.

Aktivitetet e përbashkëta:

Avokati i Popullit në partneritet me shoqërinë civile organizon aktivitete të përbashkëta në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, si: seminare, ëorkshope, konferenca, trajnime etj.

Lobim dhe advokim:

Ndërmarrja e aksioneve të përbashkëta lobuese dhe advokuese është një ndër format ku shoqëria civile dhe institucioni i Avokatit të Popullit bashkëpunojnë për të arritur qëllime të përbashkëta në përmirësimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve në vend. Bashkërendimi i forcave të Avokatit Popullit me shoqërisë civile për të identifikuar dhe adresuar çështjet e të drejtave të fëmijëve është një faktor drejt suksesit të aksionit lobues apo advokues.

Ndërgjegjësim publik:

Ndërgjegjësimi publik mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve është një tjetër fushë e bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile. Aksionet e përbashkëta me fokus zbatimin e të drejtave të fëmijëve i bëjnë partnerë në proces të dy këta aktorë. Partneriteti me shoqërinë civile lidhur me ndërgjegjësimin publik dhe jo vetëm, duhet të fillojë me hartimin e përbashkët të një strategjie kombëtare komunikimi dhe të vazhdojë me zbatimin e saj dhe sigurimin e partneritetit të qëndrueshëm.

3.2.2 Instrumentet e bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit me Shoqërinë Civile

Instrumentet e bashkëpunimit efektiv:

- Partneritete të ndërsjellta nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile dhe Avokatit të Popullit në të gjitha aspektet që lidhen me të drejtat e fëmijëve. Partneriteti me shoqërinë civile konsiston në përfshirjen e saj si partnere strategjike e Institucionit të Avokatit të Popullit.
- Aksione të ideuara dhe zbatuara së bashku, për të lobuar dhe advokuar për të drejtat e fëmijëve. Për të siguruar këtë mund të realizohen diskutime të hapura që në fillim të procesit të planifikimit të aktiviteteve

të Avokatit të Popullit dhe në veçanti të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

- Takime periodike, të drejtpërdrejta dhe gjithëpërfshirëse me aktorët e shoqërisë civile në fushën e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet ftesave të ndërsjellta; takimeve dhe angazhimeve aktive ku të jepen inpute të ndryshme në fushën e të drejtave të fëmijëve.
- Organizim aktiviteteve të përbashkëta në mjediset e institucionit të Avokatit të Popullit bazuar në qasjen gjithëpërfshirëse për fëmijët. Organizatat e shoqërisë civile mund të lehtësojnë me anë të logjistikës, por edhe buxhetimit të aktiviteteve të përbashkëta midis fëmijëve dhe institucionit të Avokatit të Popullit.
- Database me të dhënat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri dhe zonat ku operojnë ato. Si fillim mund të përdoret hartëzimi i shoqërisë civile i kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit që Institucioni i Avokatit të Popullit ka nënshkruar me organizatat e shoqërisë civile.
- Përgatitja e dokumenteve të përbashkët, që adresojnë çështje që lidhen me të drejtat e fëmijëve, në një gjuhë miqësore dhe të kuptueshme për fëmijët.
- Komunikim mbi informimin dhe bërjen publike të dokumentave zyrtare apo që adresojnë çështje lidhur me shkeljen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Angazhimi i përbashkët i institucionit të Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile në ngritjen e çështjeve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve dhe adresimit të tyre tek autoritetet përgjegjëse do të ushtrojë ndikim tek institucionet qeveritare që të marrin përgjegjësi.
- Pyetësorë të ndryshëm për të matur nivelin e bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit dhe Shoqërisë civile. Ky instrument do të shërbejë për vlerësimin e nivelit të bashkëpunimit midis tyre, por edhe për të gjetur forma bashkëpunimi më eficiente.

Anekset

Aneksi 1.1 Instrumentat ligjorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë

Instrumentet ligjorë ndërkombëtarë

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve ka marrë sot përmasa globale dhe po ashtu është adresuar gjerësisht në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Në aspektin ndërkombëtar, mbrojtja e fëmijëve bazohet në disa akte të rëndësishme, si: Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Rregullat e Pekinit, Rregullat e Riadit, KEDNJ, Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, etj. Padyshim që dokumenti më i rëndësishëm mbetet Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB (1989) me protokollat shtesë të saj.

Pavarësisht daljes së dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut si DUDNJ-ja, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike apo Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Social, Ekonomike dhe Kulturore etj, nuk kishte një akt ndërkombëtar që i dedikohet tërësisht të drejtave të fëmijës. Kjo u arrit vetëm me miratimin nga OKB-ja të **KDF**-së.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës u konsiderua si një gur themeli në lidhje me trajtimin e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Kjo Konventë përcakton standarde që garantojnë të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Ajo që vlen të theksohet lidhet me faktin se në qendër të Konventës qëndron **interesi më i lartë i fëmijës**, si konsideratë mbizotëruese në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën të marra qoftë nga institucione publike apo private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative.

Kështu, Neni 4 i KDF-së parashikon detyrimin e një shteti palë për të ndërmarrë të gjitha masat e duhura legjislative, administrative, dhe të tjera për zbatimin e të drejtave të parashikuara në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, një shtet duhet të ndërmarrë masa të tilla në masën maksimale të burimeve që disponon dhe, kur është nevoja, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në 19 dhjetor 2011, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Protokollin e Tretë Opsional të KDF-së⁴, duke krijuar një procedurë individuale të ankimimit, në rastet e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve. Ky protokoll hyri në fuqi në prill të 2014.

Sipas këtij protokollit, tri lloje të reja të ankesave janë të mundshme për të adresuar shkeljet e të drejtave të fëmijëve:

- **Komunikimet individuale** janë forma më e drejtpërdrejtë e ankesës dhe që lejojnë individët ose grupet e individëve të ankohen për shkeljen e të drejtave të tyre, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre;
- **Kërkesat** lidhen me një model më pak gjyqësor, dhe që synon thjeshtimin e procedurës për fëmijët duke parë shkeljet e rënda ose sistematike të drejtave të fëmijëve në një vend;
- **Komunikimet ndërshtetërore** u lejojnë shteteve të parashitrojnë ankesa kundër qeverive të tjera që nuk kanë arritur të përmbushin detyrimet e tyre për të drejtat e fëmijëve. Kjo procedurë mund të përdoret vetëm kundër një qeverie që i ka dhënë Komitetit leje për ta bërë këtë (këtu përfshihet dhe Shqipëria).

Nisur nga konsiderata primare e *interetit më të lartë të fëmijës*, Protokollit synon të përforcojë dhe plotësojë mekanizmat rajonalë dhe kombëtarë që u mundësojnë fëmijëve të paraqesin ankesa për shkelje të drejtave të tyre, duke ditur se statusi i tyre i veçantë mund të krijojë vështirësi për ta në ndjekjen e procedurave dhe mjeteve efektive të kompensimit/dëmshpërblimit për shkeljen e të drejtave të tyre. Protokollit inkurajon Shtetet palë për të zhvilluar mekanizma të përshtatshëm kombëtarë për t'i mundësuar një fëmije, të drejtat e të cilit janë shkelur, të ketë qasje efektive juridike në nivelin e brendshëm.

4. Ky protokoll quhet "Protokollit Fakultativ i Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me procedurën e komunikimeve", i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në 19 Dhjetor 2011, A/RES/66/138.

Protokolli i Tretë Opsional i KDF-së, ashtu si mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, mund të përdoret kur mbrojtja e fëmijëve dështon në nivel kombëtar. Ankesat nuk pranohen për shqyrtim derisa “mjetet juridike vendore të jenë shteruar”, që do të thotë që ankuesit duhet të përpiqen të zgjidhin çështjet përmes sistemit ligjor kombëtar përpara se të paraqesin ankesë në Komitetin për të Drejtat e Fëmijës.

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është një nga objektivat e BE-së në të cilën Traktati mbi Bashkimin Evropian (veçanërisht neni 3) vë theks të mëtijshëm. Të drejtat e fëmijës janë të pasqyruara edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, ku neni 24 i Kartës njeh se fëmijët janë bartës të pavarur dhe autonomë të të drejtave të tyre.

Neni 24 i Kartës gjithashtu njeh *interesin më të lartë të fëmijës* si një konsideratë primare për autoritetet publike dhe institucionet private. Në këtë kontekst, duke ndjekur Komunikatën e Komisionit të datës 4 korrik 2006 (COM (2006) 367 final): *drejt një Strategjie të BE-së mbi të Drejtat e Fëmijës*, Komisioni Evropian miratoi një agjendë të BE-së për të Drejtat e Fëmijëve në shkurt 2011, duke riafirmuar angazhimin e fortë të të gjitha institucioneve të BE-së për promovimin, mbrojtjen dhe plotësimin e të drejtave të fëmijës në të gjitha politikat përkatëse. Agjenda e BE riafirmmon se standardet dhe parimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës duhet të vazhdojnë të udhëheqin politikat dhe veprimet e BE-së që kanë një ndikim mbi të drejtat e fëmijës. Për më tepër, “perspektiva e të drejtave të fëmijëve” duhet të merret parasysh në të gjitha masat që prekin fëmijët.

Një vend i rëndësishëm i është kushtuar mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në planin evropian. Kështu p.sh. Udhëzimet e Këshillit të Evropës për një *sistem drejtësie miqësor për fëmijët* (2010) janë miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës dhe synojnë të mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e fëmijës në lidhje me informimin, përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në procedurat administrative dhe gjyqësore, duke u mundësuar atyre këto të drejta në të gjitha fazat e procedimit.

Gjithashtu, përmendim *Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi Strategjitë e Integruara Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna* që synojnë një kuadër kombëtar shumë-disiplinor dhe sistematik për të parandaluar dhe për t’ju përgjigjur rasteve të dhunës kundër fëmijëve. Përmes Udhëzimeve synohet të ketë edhe një ndryshim kulturor e institucional shumë të nevojshëm në perceptimin e fëmijëve si aktorë ndryshimi dhe të fëmijërisë si një faktor i rëndësishëm për shoqërinë në tërësi, gjë që do të afektojë edhe politikat dhe praktikën tonë të brendshme.

Po ashtu për rëndësinë që ka në planin evropian, në këtë trajtim nuk mund të lemë pa përmendur edhe KEDNJ-ja dhe Jurisprudencën e GJEDNJ-së. Veçanërisht në lidhje me fëmijët, theksojmë rastet e paraqitura para kësaj Gjykate në lidhje me nenin 8, 6, 5 dhe 3 të Konventës⁵ të gërshetuara në mjaft raste edhe me neni 14 të saj.

Siç e ka theksuar GJEDNJ, në çdo rast, parimi që duhet të mbizotërojë është ai i *interesit më të lartë të fëmijës*. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut ofron një larmishmëri rastesh në lidhje me respektimin e të drejtave në çështje që implikojnë të mitur.

Ajo që vlen të theksohet është qasja që gërsheton nevojën për të garantuar gjithmonë të drejtat e fëmijës në lidhje me informacionin, përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në procedurat administrative dhe gjyqësore, duke i njohur atyre këto të drejta në të gjitha fazat e procedimit, por duke pasur në vëmendje se duhet të respektohet dhe të mbrohet jeta private, interesat, nevojat e veçanta, dinjteti individual i fëmijës.

Po ashtu, një dokument tjetër i rëndësishëm është Karta Sociale Evropiane (e rishikuar), e cila përmban në mënyrë të veçantë dispozita lidhur me përmirësimin e të drejtave të fëmijëve. Neni 7 kërkon që shtetet të ndërmarrin veprime për të siguruar “ushtrimin efektiv të të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje” dhe Neni 17 parashikon të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje sociale, ligjore dhe ekonomike. Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale mbikëqyr përputhshmërinë e ligjit dhe praktikës kombëtare me Kartën. E rëndësishme është të përmendim se, Karta Sociale përfshin një ‘procedurë të ankesave kolektive’ e cila lejon organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera të përcaktuara për paraqitjen e ankesave, kur ngrihet pretendimi se një shtet nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e Kartës. Kjo procedurë është përshkruar si një mekanizëm inovativ, eficient, i arritshëm dhe i thjeshtë për të mbështetur të drejtat e fëmijëve⁶.

Instrumentet ligjorë kombëtarë

Progres i rëndësishëm është bërë në sjelljen e legjislacionit shqiptar dhe praktikave në përputhje me standardet ndërkombëtare, angazhimet në kuadër të proceseve

5 Neni 8 – E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare; neni 6 – E drejta për një proces të rregullt; neni 5 – e drejta për liri dhe siguri; neni 3 – ndalimi i torturës; neni 14 – ndalimi i diskriminimit.

6. Migena Leskoviku (2012), “Legjislacioni shqiptar për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve në Shqipëri. Harmonizimi i tij me legjislacionin dhe praktikën europiane”, referuar në Konferencën Shkencore Kombëtare ‘Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri’, Tiranë, 21 nëntor 2012. Referimi botuar në Proceedings të Konferencës, fq. 249-257. ISBN: 9789928162-52-6.

integruese dhe praktikave më të mira. Ky është një proces dinamik, i cili po vijon. Këto zhvillime kanë ardhur si rezultat i një mase të gjerë advokimi dhe trajnimi, mbështetur nga programet e organizatave ndërkombëtare, në interes të partnerëve qeveritarë si dhe me pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile. Ndryshimet përfshijnë masa ligjore, administrative, në infrastrukturë dhe burime njerëzore, udhëhequr nga mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës.

Në përputhje me angazhimet ndërkombëtare, vëmendje i është kushtuar zhvillimit dhe zbatimit të parimeve, standardeve dhe strategjive që adresojnë rolin dhe statusin e fëmijës.

Në themel të tyre qëndron ideja se fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për një mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore.

Në procesin e reformimit dhe harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me atë ndërkombëtar e evropian, vlen të theksohet nevoja për promovimin e një kulture për respektimin e të drejtave të fëmijës, të bazuar në njohuri të thella për të drejtat e fëmijës dhe të kuptuarit e dobësive dhe aftësive të fëmijëve. Grupi përfutues kryesor duhet të përfshijë vetë fëmijët, prindrit si dhe të gjithë profesionistët që kanë të bëjnë dhe janë në kontakt me fëmijët.

Kushtetuta e RSH përcakton se fëmijët gëzojnë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti (Neni 54). Gjithashtu, e drejta për arsim është një e drejtë tjetër themelore që u referohet posaçërisht fëmijëve (neni 57).

Po ashtu në nenin 59 Kushtetuta jonë parashikon:

“Shteti, në bazë të pushtetit kushtetues dhe mjeteve në dispozicion, si dhe për të mbështetur nismën dhe përgjegjësinë private, synon:

- *Kushte të përshtatshme pune për individët në gjendje pune;*
- *Standardet më të larta të mundshme për shëndetin fizik dhe mendor;*
- *Edukimin dhe kualifikimin e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe të punësuarve sipas aftësive të tyre përkatëse;*
- *Zhvillimin e sporteve dhe aktiviteteve argëtuese;*
- *Kujdes dhe ndihmë për të moshuarit, jetimët dhe personat me aftësi të kufizuara;*
- *Një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezin aktual dhe brezat e ardhshëm”.*

Ndër ato pjesë të legjislacionit që trajtojnë çështje që lidhen me fëmijët, ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Referuar parimeve bazë që ai përcakton, theks i veçantë i kushtohet garantimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Ky ligj ka për qëllim:

- a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;
- b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikase, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;
- c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit në cilësi të jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik; ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;
- d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;
- dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;
- e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Ligji përcakton se autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshatshme për fëmijën.

Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh: a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje; b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar; c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen; ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës; d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Nisur nga specifikat e tyre, duke iu referuar legjislacionit shqiptar, fëmijët gëzojnë një sërë të drejtash për mirërritjen, mirë edukimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e shëndetit të tyre, duke theksuar prioritarizimin për zbatimin praktik të tyre.

Gjithashtu, me rëndësi në ligj është edhe mbrojtja e posaçme që rezervohet për kategori të caktuara të fëmijëve.

Në themel të këtij kuadri ligjor qëndron qasja se dhuna dhe çdo formë tjetër shkelje apo keqtrajtimi kundër fëmijëve përbën shkelje të drejtave të fëmijëve, komprometon zhvillimin e fëmijëve dhe cënon gëzimin e të drejtave të tyre bazë; si dhe duke pasur parasysh se brishtësia, vulnerabiliteti i fëmijëve dhe varësia e tyre tek të rriturit për rritjen dhe zhvillimin kërkojnë një investim më të madh në parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijëve nga familjet, shoqëria dhe shteti. Mangësitë në zbatimin praktik për garantimin e këtyre të drejtave, në ndërhyrjet e strukturave shtetërore dhe komunitare i bën fëmijët më të ekspozuar ndaj dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit. Kështu që njohja, garantimi dhe mbrojtja e të drejtave fuqizon rolin e fëmijës në shoqëri dhe parandalon cënimin e jetës, shëndetit, dinjitetit dhe mirëqenies së tyre.

Pavarësisht arritjeve pozitive në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe përmirësimit të kuadrit ligjor, ende mbetet shumë për të bërë në lidhje me mekanizmin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

Me rëndësi është koordinimi dhe organizimi i sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna, si përmes strukturave qendrore ashtu edhe atyre vendore.

Ndër të tjera për tu përmendur është fakti se në parashikimet ligjore, e konkretisht në pikën 7, të nenit 34 të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ngarkohet Avokati i Popullit për monitorimin e zbatimit të këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Aneks 1.2 Ushtrim që do të përdoret nga AP për të matur Shkallët e Pjesëmarrjes së Fëmijëve⁷

Ka lloje të ndryshme të pjesëmarrjes. Shkallët e pjesëmarrjes së fëmijëve duke u ngjitur, bëhen gjithnjë e më shumë kuptimplotë dhe të vërteta, teksa lëvizet nga shkalla e tetë (Manipulimi) deri në të parë (Fëmijët marrin iniciativën dhe vendosin vetë). Tre nivelet e para (8,7,6) nuk mund të konsiderohen me të vërtetë pjesëmarrëse, por pesë nivelet e tjera, janë të përshtatshme për fëmijët drejt angazhimit në shkallën më të lartë të pjesëmarrjes që është ajo e shkallës së parë. Në këto pesë nivele kanë evoluar aftësitë e tyre pjesëmarrëse dhe vendimmarrëse.

Referuar teorive të pjesëmarrjes aktive të fëmijëve, thuhet se pjesëmarrja e vërtetë fillon me shkallën e konsultimit. Të gjitha shkallët e përmendura poshtë shkallës së konsultimit kanë të bëjnë me mospjesëmarrje. Që të zbatohet e drejta e fëmijëve për pjesëmarrje aktive, duhet të mos përdorim shkallët respektive 5,6,7 dhe 8. Që të sigurojmë pjesëmarrje aktive duhet të synojmë konsultimin dhe marrjen e vendimeve të përbashkëta.

Gjithashtu, referuar pjesëmarrjes së fëmijëve janë 3 aspekte që lidhen me zbatimin e shkallëve të pjesëmarrjes 1) të mbrohet e drejta për të marrë pjesë, 2) të promovohet e drejta për pjesëmarrje dhe 3) të krijohet hapësirë për zbatimin e pjesëmarrjes.

7. Shkallët e pjesëmarrjes së fëmijëve janë adaptuar nga Roger Hart A.

1. Shkalla e kalimit të gjithë përgjegjesisë të fëmijët

Kur fëmijët marrin iniciativën dhe venosin se çfatë do të bëjnë në një aktivitet. Të rriturit përfshihen vetëm kur fëmijët kërkojnë ndihmë.

2. Shkalla e drejtimit nga fëmijët/ Të rriturit ndihmojnë

Kur fëmijët marrin iniciativën për një aktivitet dhe të rriturit ndihmojnë.

3. Shkalla e vendimit të përbashkët

Kur të rriturit marrin iniciativën për një aktivitet, por vendimet merren bashkarisht me fëmijë.

4. Shkalla e konsultimit

Kur të rriturit konsultojnë fëmijët dhe konsiderojnë me kujdes mendimin e tyre, marrin parasysh gjithë opinionet e dhëna.

5. Shkalla e ftesës (përcaktimi nga të rriturit)

Kur të rriturit ftojnë fëmijët të japin idetë e tyre, por marrin vendime sipas dëshirës së tyre.

6. Shkalla e tokenizimit

Kur të rriturit vendosin se çfarë të bëhet ndërsa fëmijët janë të lejuar të bëjnë disa ndryshime të vogla.

7. Shkalla e dekoracionit

Kur të rriturit vendosin se çfarë të bëhet. Fëmijët marrin pjesë në aktivitetet nëpërmjet këngës, valleve apo funksione të tjera ceremoniale, si p.sh.: përshëndetje në një konferencë.

8. Shkalla e manipulimit

Kur të rriturit vendosin se çfarë të bëhet dhe pyesin fëmijët nëse bien dakord me vendimet e tyre apo jo. Në fakt, ata e bëjnë këtë në një mënyrë të tillë që fëmijët të mos kenë rrugë tjetër, po veçse të bien dakord.

Metodologjia

Udhëzuesi: **“Për bashkëpunimin e Institucionit të Avokatit të Popullit me Fëmijët dhe Shoqërinë Civile”** është kryer nga një grup pune i përbërë nga ekspert të fushës së të drejtave të fëmijëve. Një rol shumë të rëndësishëm në përgatitjen e këtij dokumenti kanë luajtur fëmijët të cilët kanë qenë një burim i madh informacioni si dhe kanë kontribuar me mendimet dhe sugjerimet e tyre në trajtimin e çështjes së bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët. Gjithashtu, përfaqësues të shoqërisë civile ndihmuan në aspektin e bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me shoqërinë civile si dhe kontribuan në identifikimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve se çfarë ata presin nga ky institucion.

Metodat e përdorura:

- **Analiza e të dhënave parësore;**

Analiza e të dhënave parësore është fokusuar në: 1) analizën e fokus grupeve me fëmijët pjesë e grupit “zëri 16+” nga qyteti i Gjirokastrës, Durrësit, Elbasanit, Burrelit dhe Tiranës. 2) Intervista me përfaqësues të shoqërisë civile të cilat punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar dhe lokal. 3) Janë realizuar intervista me përfaqësues të Seksionit të Fëmijëve, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Seksioni i Përgjithshëm, në Institucionin e Avokatit të Popullit në Shqipëri.

- **Analizë e të dhënave dytësore;**

Analiza dytësore ka konsistuar në analizën e legjislacionit vendas dhe aktet kryesore ndërkombëtare në këtë fushë, analizën e raporteve, studimeve, strategjive si dhe dokumenteve zyrtare qeveritare dhe joqeveritare që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve dhe

pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje si dhe dokumenteve që lidhen me objektin e guidës. Pjesë e të dhënave dytësore ka qenë edhe monitorimi i faqes së internetit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri. Gjithashtu, është realizuar analiza e modeleve të Institucioneve të Avokatit të Popullit në Evropë për t'u paraqitur si modele referente në kuadër të instrumentave të bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit me fëmijët dhe shoqërinë civile.

5.1. Analiza e fokus grupeve dhe intervistave të drejtpërdrejta

A. Përshkrimi i të dhënave demografike të të intervistuarve me fokus grup dhe pjesëmarrësit në intervistat e drejtpërdrejta

Për të realizuar intervistat me fokus grup u përfshinë 47 fëmijë të moshës 14-18 vjeç. Fokus grupet u zhvilluan në tre qytete Tiranë, Durrës dhe Elbasan një fokus grup për çdo qytet. Fëmijët ishin banorë të qytetit të Durrësit, Elbasanit, Gjirokastrës, Tiranës dhe Burrelit. Të dhënat e fëmijëve pjesëmarrës, sipas gjinisë ishin respektivisht: 14 djem dhe 33 vajza. Kjo ndarje në proporcion jo të drejtë ishte e rastësishme dhe jo e qëllimshme. Në përzgjedhjen e fëmijëve pjesëmarrës ishte kusht i përcaktuar më parë, që ata të ishin pjesë e grupimit “Zëri16+”. Këto të dhëna edhe pse nuk kanë qenë të rastësishme, por të qëllimshme, janë bazuar në parimin e pranueshmërisë dhe pjesëmarrjes aktive, pra janë bërë pjesë e fokus grupeve ata fëmijë të cilët i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës për të marrë pjesë në to.

Përsa i përket të dhënave të të intervistuarve pjesë e shoqërisë civile përzgjedhja ka qenë e qëllimshme dhe ka patur në konsideratë faktin se organizatat janë ndërkombëtare apo kombëtare dhe kanë në prioritet e tyre pjesëmarrjen e fëmijëve si dhe kanë patur bashkëpunime me institucionin e Avokatit të Popullit. Emrat e organizatave që janë bërë pjesë e intervistave janë konsultuar edhe me anëtarët e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Seksioni i Përgjithshëm, në Institucionin e Avokatit të Popullit në Shqipëri.

B. Analiza e gjetjeve nga intervistat me fokus grup me fëmijët dhe me organizatat e shoqërisë civile

B.1 Analiza e gjetjeve nga intervistat me fokus grup me fëmijët

Intervistat me fokus grup për fëmijët janë strukturuar në disa pjesë: 1) Informacion mbi njohjen e institucionit të Avokatit të Popullit, rolin dhe funksionet e tij, 2) bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët, format e bashkëpunimit, instrumentet e bashkëpunimit 3) informacion mbi kërkesë Ankesat drejtuar Avokatit të Popullit, 4) modelet e suksesshme mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në vendet e tjera, 5) propozime nga fëmijët mbi përmirësimin e bashkëpunimit midis institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët.

Intervistat e drejtpërdrejta me aktorë e shoqërisë civile dhe përfaqësues të qendrave rezidenciale janë strukturuar në: 1) bashkëpunimi i deritanishëm me institucionin e Avokatit të Popullit; 2) format dhe instrumentat e bashkëpunimit midis institucionit të Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile; 3) bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët që punojnë këto organizata; 4) rekomandime mbi përmirësimin e bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe shoqërinë civile.

1) Informacion mbi njohjen e institucionit të Avokatit të Popullit, rolin dhe funksionet e tij

Lidhur me pyetjen **“Listoni nga tre fjalë që personifikojnë Avokatin e Popullit”** 75% e fëmijëve kanë listuar më së shumti (vlerësuar sipas modelit të pikëzimit) fjalët *“mbrojtje”* *“zgjidh problemet”* *“mbështetës”* *“mbron të drejtat e popullit”* *“mbron të drejtat e fëmijëve”* *“përçon zërin e popullit”* dhe *“merret me ligjet”*. Kurse pjesa tjetër prej 25 % ka listuar *“është i pavarur”*, *“mbron grupet në nevojë”*, *“trajton ankesat e personave”* dhe *“të ndihmojë fëmijët në çdo hap”*.

Përafërsisht 75% e fëmijëve e dinin se cili ishte emri i Avokatit të mëparshëm, por ata nuk njihnin funksionin dhe rolin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe nëse është institucion pjesë e qeverisë apo jo. 25 % e fëmijëve nuk e dinin emrin e ish Avokatit të Popullit.

“Emrin e Avokatit të Popullit thjesht e kemi dëgjuar në televizor dhe kemi lexuar për të në shkollë si një institucion bashkë me institucionet e tjera si parlamenti dhe qeveria, nuk e dimë shumë mirë rolin e tij më shumë e marrim me mend që mund të jetë kështu...” thotë një vajzë nga Elbasani, pjesëmarrëse në fokus grup.

Fëmijët kanë informacion në nivele të përgjithshme mbi rolin e Avokatit të Popullit, por ky informacion herë pas here është i hamendësuar dhe nuk është i saktë dhe i plotë. Ndërkaq, ata nuk kanë informacion mbi funksionet e tij si dhe nuk marrin informacion mbi të rejat e këtij institucioni. Mungon informacioni i plotë dhe i saktë në kurrikulat shkollore.

2) Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët, format e bashkëpunimit, instrumentet e bashkëpunimit

Përsa i përket mendimeve të fëmijëve lidhur me bashkëpunimin midis Avokatit të Popullit me fëmijët, u hartuan pyetjet orientuese të cilat ishin pjesë e kësaj kategorie respektivisht pyetjet 2 dhe 3. **2. Kë person njihni nga institucioni i Avokatit të Popullit? Si e ka emrin ai?** dhe pyetjes **3. E keni takuar ndonjëherë Avokatin e Popullit apo ndonjë përfaqësues të tij, nëse po, kur? Ka ardhur ndonjëherë në shkollën tuaj ndonjë përfaqësues i Avokatit të Popullit? Nëse po mund të përshkruani si ka qenë takimi me të?**

Ata nuk kanë patur asnjë bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit .

“Nuk ka ardhur në shkollë asnjëherë, nuk e kemi takuar, nuk e dimë që ka sektorë për fëmijët në këtë institucion, hera e parë që e dëgjojmë” shprehet një djalë nga Burreli pjesë e fokus grupit në Tiranë,

Një vajzë nga Elbasani, pjesë e grupit “Zëri 16+” në Elbasan ka marrë pjesë në një takim në Tiranë ku e pranishme ka qenë një përfaqësuese nga Avokati i Popullit.

“Isha në Tiranë në një konferencë që e zhvillonte Save the Children dhe atje dëgjova një prezantim nga një grua e cila përfaqësonte institucionin e Avokatit të Popullit” shprehet ajo gjatë zhvillimit të fokus grupit në Elbasan.

Bazuar në gjetjet e mësipërme mund të themi se bashkëpunimi midis Avokatit të Popullit dhe fëmijëve është në nivele të ulta. Ky fakt lidhet me mungesën e prezencës së institucionit të Avokatit të Popullit në mjediset e shkollës, mungesa e zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta me/për fëmijët si dhe në mungesën e kontakteve të drejtpërdrejta apo atyre me përfaqësi të Avokatit të Popullit me fëmijët.

3) Informacion mbi kërkesat dhe ankesat drejtuar Avokatit të Popullit

Përsa i përket kësaj pike të gjithë fëmijët nuk e dinin që mund të dërgonin kërkesa dhe ankesa në adresë të Avokatit të Popullit.

“Hera e parë që e dëgjojmë që avokati i popullit mund të shqyrtojë kërkesat e fëmijëve” shprehet një djalë nga grupimi “Zëri 16+” nga Durrësi.

Mendimet e fëmijëve lidhur me kërkesat dhe ankesat u përfatuan si përgjigje e pyetjes **4. Listoni tre emra se ku i drejtoheni kur ju keni ndonjë ankesë apo kërkesë?** Në asnjë rast, fëmijët nuk kishin listuar Avokatin e Popullit që mund t'i drejtoheshin nëse kishin ndonjë kërkesë apo ankesë.

Sipas metodës së pikëzimit pjesa më e madhe e fëmijëve listuan “mësuesin”, “prindërit”, “drejtorin e shkollës” dhe “psikologun” dhe në disa raste listuan “policinë” dhe “gjykatën”. Ndërkaq, edhe në diskutimet që lidheshin me kërkesën dhe ankesën nxorën si problem raportin e besimit që institucioni i Avokatit të Popullit do të trajtojë suksesshëm kërkesën apo ankesën e fëmijëve.

“Nëse do t’a takoja drejtpërdrejtë Avokatin e Popullit do të kisha mundësi ta pyesja se si i trajton ai rastet kur fëmijët ankohen për shfaqjen e dhunës në shkollë” shprehet një vajzë 13-veç pjesë e grupimit “Zëri 16+” nga Elbasani.

4) Modelet e suksesshme të institucionit të Avokatit të Popullit në vendet e tjera

Asnjë prej fëmijëve nuk ka informacion mbi modele të suksesshme të bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me fëmijët. Personi që moderonte fokus grupin u kërkoi dhe

inkurajoi fëmijët të hulumtonin në internet dhe të dërgonin me email mendimet dhe sugjerimet lidhur me modelet e bashkëpunimit që atyre u duken, si të suksesshme, por asnjë prej fëmijëve nuk dërgoi e-mail.

Fëmijët nuk kanë informacion mbi modelet e suksesshme të bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit dhe fëmijëve. Kjo gjetje doli nga diskutimi mbi pyetjen **“Njihni ndonjë Avokat Populli nga vendet e tjera, si janë ata mund të përshkruaj dikush?**

5) Propozime mbi përmirësimin e bashkëpunimit midis Institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët

Në diskutimin mbi këtë çështje, fëmijët sollën shumë “inpute” ata dhanë shume sugjerime, ide, mbi përmirësimin e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me fëmijët. Ky diskutim u orientua nga pyetja: **Çfarë duhet të bëjë Avokati i Popullit për të qenë sa më pranë jush dhe fëmijëve të tjerë?**

Të gjithë fëmijët pjesëmarrës listuan një numër të konsiderueshëm, sugjerimesh dhe instrumentesh sesi Avokati i Popullit të jetë sa më pranë fëmijëve. Duke përdorur edhe në këtë rast metodën e pikëzimit fëmijët propozuan:

- Fushata masive informimi periodike;
- Vendosja në kurrikulat shkollore të informacionit mbi rolin dhe funksionimit e Avokatit të Popullit;
- Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese dhe informuese mbi rolin dhe funksionimin e Avokatit të Popullit;
- Cikle emisionesh televizive periodike ku diskutohet pjesëmarrja e fëmijëve dhe bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me fëmijët;
- Përgatitja e manualeve apo udhëzimeve mbi përgatitjen e kërkesave dhe ankesave që i adresohen Avokatit të Popullit;
- Mbledhja e të dhënave mbi ankesat dhe kërkesat e fëmijëve të cilat i adresohen Avokatit të Popullit;
- Ofrimi i shërbimit elektronik të chat-it online ku mund t’u jepen përgjigje pyetjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve;
- Kontakte të drejtpërdrejta me fëmijët nëpërmjet takimeve të ndryshme, vizitave në institucionin e Avokatit të Popullit etj;

- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta të institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët;
- Promovimi i rasteve të trajtuara suksesshëm nga Avokati i Popullit dhe që kanë patur zgjidhje në interes të fëmijëve;

B.2 Analiza e gjetjeve nga intervistat e drejtpërdrejta me aktorë e shoqërisë civile dhe përfaqësues të qendrave rezidenciale

Intervistat me shoqërinë civile u strukturuan në tre pjesë: 1) Situata e deritanishme e bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit me shoqërinë civile, 2) Situata e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me fëmijët sipas perspektivës së shoqërisë civile, 3) Rekomandime dhe sugjerime për përmirësimin e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe shoqërinë civile.

1) Situata e deritanishme e bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit me shoqërinë civile

Të gjithë të intervistuarit me intervista të drejtpërdrejta, të cilët ishin përfaqësues të shoqërisë civile ishin të mendimit që bashkëpunimi i deritanishëm me institucionin e Avokatit të Popullit nuk ka qënë në nivele të larta.

Lidhur me aspektin e iniciativave të përbashkëta lobuese apo advokuese të intervistuarit u shprehën se nuk ka patur të tilla, thjesht kanë qënë iniciativa legjislative siç ka qënë ajo e diskutimit të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve nr **Nr. 18/2017**, ku shoqëria civile dhe Avokati i Popullit kanë marrë pjesë në diskutimet në komisionin e ligjeve si përfaqësues më vete jo si një zë i përbashkët.

2) Format dhe instrumentet e bashkëpunimit midis institucionit të Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile

Format e bashkëpunimit kanë qënë të llojit formal dhe jo partneritet të ngushtë. Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile ka patur bashkëpunime në raste të organizimit të aktiviteteve që kishin fokus të drejtat e fëmijëve të llojit, konferenca, ëorkshope ku Avokati i Popullit ka thirrur organizata të shoqërisë civile ose ka marrë pjesë në aktivitete të iniciara nga shoqërisë civile.

Formë tjetër të bashkëpunimit ka qënë ajo e marrjes së ekspertizës nga shoqëria civile për përgatitjen e dokumenteve të ndryshëm apo raporteve.

“Përgjithësisht Avokati i Popullit nuk përdor të dhënat e shoqërisë civile në dokumentet e tij” shprehet përfaqësuesi i Fondacionit World Vision Albania.

Në komunitetin e gjerë të shoqërisë civile ka një mungesë informacioni mbi mënyrën e funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit. Kjo vjen si rrjedhojë që Avokati i Popullit nuk ka partneritet me dinamikë dhe një marrëdhënie të konsoliduar dhe të qëndrueshme me shoqërinë civile. Faktorët në këtë nivel bashkëpunimi janë dypalësh ato nuk janë vetëm përgjegjësi e Avokatit të Popullit, por edhe e shoqërisë civile.

“Edhe shoqëria civile nuk i është përgjigjur gjithmonë me seriozitet thirrjeve të Avokatit të Popullit për bashkëpunim..” thotë Altin Hazizaj, Drejtor i CRCA

Herë pas here iniciativat e institucionit të Avokatit të Popullit nuk bëhen publike në nivel të gjerë të shoqërisë civile vetëm me disa organizata ndahet informacioni dhe përgjithësisht këto organizata janë të nivelit ndërkombëtar.

Gjithashtu, mungojnë modelet e aksioneve të përbashkëta me shoqërinë civile mbi ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi të drejtat e fëmijëve.

3) Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët me të cilët punojnë këto organizata

Lidhur me këtë aspekt nga të gjithë të intervistuarit është thënë se nuk ka patur asnjë bashkëpunim me fëmijët me të cilët punojnë këto organizata. Pra ky bashkëpunim nuk ekziston. Disa nga arsyt e mungesës së këtij bashkëpunimi ka qënë mungesa e informacionit të fëmijëve mbi rolin dhe funksionin e Avokatit të Popullit.

4) Rekomandime mbi përmirësimin e bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe shoqërinë civile

Të intervistuarit dhanë një sërë rekomandimesh për përmirësimin e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe me shoqërinë civile. Të gjithë u përqendruan në disa rekomandime kyçe: #vendosja e një Komisioneri për Mbrojtjen dhe

Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve për të drejtat e fëmijëve, #informimi i fëmijëve mbi rolin dhe funksionimin e Avokatit të Popullit nëpërmjet fushatave periodike ndërgjegjësuese dhe informuese, kontakteve të drejtpërdrejta me fëmijët, aktivitetet e përbashkëta me fëmijët bazuar në nivelet e larta të pjesëmarrjes së fëmijëve, #regjistrimi, mbledhja e administrimi i të dhënave mbi kërkesat dhe ankesat, #promovimi i rasteve të suksesshme të trajtimit të ankesave apo kërkesave, #përmirësimi i faqes zyrtare së internetit të Avokatit të Popullit me informacione me një gjuhë miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët.

Lista e personave të intervistuar		
Emër/Mbiemër	Institucioni	Email
Anila Nepravishta Matilda Tyli Ira Papagjika	Avokati i Popullit	anepnavishta@avokatipopullit.gov.al mtyli@avokatipopullit.gov.al ipapagjika@avokatipopullit.gov.al
Jezerca Tagani	Terres Des Homess	jezerca.tigani@tdh.ch
Altin Hazizaj Mersila Ballo	CRCA	Altin.hazizaj@crca.al
Eva Bisha	Shërbimi Social Shtetëror	Etleva.Bisha@sherbimisocial.gov.al
Julian Papaproku	World Vision	julian_papaproku@wvi.org
Soela Kotherja	BKTF	soelakotherja@yahoo.it
Teuta Shkenza	SOS Fshatrat e Fëmijëve	teuta.shkenza@soskd.org.al

5.2. Intervistat me fokus grup me fëmijët

Intervistat me Fokus grup me fëmijët /të rinjtë

Informacion mbi diskutimin,

Të dashur fëmijë/të rinjë, Unë jam Alma Kordoni dhe jam këtu për të diskutuar me ju për Avokatin e Popullit dhe për bashkëpunimin e tij me ju. Duke qenë se, ju jeni disa nga fëmijët e përzgjedhur do të doja shumë që të ndanit me ne sot, mendimet, sugjerimet dhe idetë tuaja. Ky fakt do ta ndihmonte institucionin e Avokatit të Popullit që të jetë sa më pranë jush dhe fëmijëve të tjerë për çdo shqetësim apo ankesë që ata kanë.

Unë kërkojë pjesëmarrjen tuaj në këtë diskutim me qëllim marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve tuaja mbi këtë çështje. Ndërkaq, me lejen tuaj intervista do të regjistrohet në audio d.m.th me zë dhe jo me figurë. Përgjigjet tuaja në intervistë do të jenë absolutisht konfidenciale. Regjistrimi do të kodifikohet dhe nuk do të përmbajë emrat tuaj. Ky regjistrim do të ruhet me shumë kujdes.

Vendimi juaj për të marrë pjesë në këtë fokus grup ose jo nuk do të ndikojë në bashkëpunimin tuaj me organizatën Save the Children apo me shkollat tuaja respektive. Nëse pranoi të merrni pjesë ju lutem plotësoni listën e pjesëmarrësve. Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen tuaj në këtë udhëzues, doja t'u bëja me dije se angazhimi juaj në këtë fokus grup vlerësohet si një kontribut i madh për përmirësimin e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe për zhvillimin e pjesëmarrjes së fëmijëve si një nga parimet e Konventës së të Drejtave të Fëmijëve.

Unë do t'u drejtoj disa pyetje të cilat do të orientojnë diskutimin, por gjithashtu, do t'u lutesha dhe do t'u inkurajoja që të shprehnit mendimin tuaj të lirë dhe sipas mënyrës tuaj.

Data: _____

Ora: _____

Vendi: _____

Ju faleminderit për ndihmën!

Shënim: Para se të fillojnë pyetjet fëmijëve u kërkohet të prezantojnë veten e tyre. Më pas vazhdohet me pyetjet.

#1. Listoni nga tre fjalë që personifikojnë Avokatin e Popullit?

Shënim: Fëmijëve u shpërndahen letra me ngjyra ku të shkruajnë mendimet e tyre. Ato ngjiten në një flipchater dhe u kërkohet që një nga fëmijët që t'i lexojë. Diskutojnë mbi atë çfarë ata kanë shkruar me qëllim të përfitohet një pasqyrë më e plotë e mendimeve të tyre.

#2. Kë person njihni nga institucioni i Avokatit të Popullit? Si e ka emrin ai?

#3. E keni takuar ndonjëherë Avokatin e Popullit apo ndonjë përfaqësues të tij, nëse po, kur? Ka ardhur ndonjëherë në shkollën tuaj ndonjë përfaqësues i Avokatit të Popullit? Nëse po mund të përshkruani si ka qenë takimi me të?

4. Listoni tre emra se ku i drejtoheni kur ju keni ndonjë ankesë apo kërkesë? Shënim: Nëse ndonjë nga fëmijët përmend Avokatin e Popullit, diskutojmë rreth faktit që në ç'mënyrë i drejtohen, cilat janë rrugët e komunikimit me të?

#5 Supozojmë se duam të bëjmë një ankesë dhe një kërkesë drejtuar Avokatit të Popullit, çfarë do të përmbajë ajo? Provojmë të shkruajmë një. Shënim: fëmijët diskutojnë kurse njëri prej fëmijëve shkruan në një flipcharter se çfarë duhet të përmbajë një kërkesë dhe një ankesë?

#6. Si mendoni, çfarë duhet të bëjë Avokati i Popullit për të qenë sa më pranë jush dhe fëmijëve të tjerë? Ju lutem Listoni 3 sugjerime , Shënim: Fëmijëve u shpërndahen letra me ngjyra ku të shkruajnë mendimet e tyre. Ato ngjiten në një flipchater dhe u kërkohet që një nga fëmijët që t'i lexojë.

#7. Njihni ndonjë Avokat Populli nga vendet e tjera, si janë ata mund ta përshkruaj dikush?

#8. Imagjinoni, nëse secili nga ju është pjesë e grupit përfaqësues të fëmijëve tek Avokat i Popullit, çfarë do bënit ju për fëmijët e tjerë?

Shënim: Fëmijët lihen për 3-4 minuta të imagjinojnë. Pastaj diskutohet mbi imagjinatën e tyre.

BIBLIOGRAFIA

- i. Child participation assessment tool, Council of Europe/ <https://rm.coe.int/16806482d9>;
- ii. <http://www.childrenscommissioner.gov.uk/learn-more/child-participation>;
- iii. Hart, R.A. "Children's participation, the theory and practice of involving young citizens in community development and environment care". Taken from Alderson, P. "Young Children's Rights, Exploring believes, principles and practice" 2001, page 92;
- iv. <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/RAPORTI%20SHQIP%202015%20.pdf>;
- v. Guide implementation child participation, Council of Europe;
- vi. <http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/të-drejtat-e-fëmijëve>;
- vii. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- viii. Ligji nr. 8454, dt. 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar;
- ix. Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- x. Migena Leskoviku (2012), "Legjislacioni shqiptar për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve në Shqipëri. Harmonizimi i tij me legjislacionin dhe praktikën europiane", referuar në Konferencën Shkencore Kombëtare 'Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri', Tiranë, 21 nëntor 2012. Proceedings: ISBN: 9789928162-52-6.
- xi. Konventa për të Drejtat e Fëmijës e OKB;
- xii. Protokollin i Tretë Fakultativ i Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me procedurën e komunikimeve", i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në 19 Dhjetor 2011;
- xiii. Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Vendime të GJEDNJ;
- xiv. Udhëzimet e Këshillit të Europës për një sistem drejtësie miqësor për fëmijët (2010) miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës;
- xv. Ligji nr 9094, datë 03.07. 2003 "Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës për Parandalimin e Torturës dhe të Gjitha Formave të Tjera të Trajtitimit Çnjerëzor apo Degradues";
- xvi. Karta Sociale Evropiane (e rishikuar);



Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929

E-mail: info.albania@savethechildren.org

<https://albania.savethechildren.net>



Savethechildrenal



SaveChildrenAlb